

NË EMËR TË POPULLIT

GJYKATA THEMELORE NË PRISHTINË-Departamenti i përgjithshëm, me gjyqtarene vetme gjykuese Fatime Dërrmaku, me zyrtaren ligjore Edona Grajçevci, në çështjen penale, kundër të pandehurit R.K., për shkak të veprës penale Rrezikim i trafikut publik nga neni 378 par.6 lidhur me par. 1, të KPRK-së, i akuzuar sipas Aktakuzës së Prokurorisë Themelore në Prishtinë-Departamenti i Përgjithshëm, PP.II.nr.551/17, të datës 07.06.2017, duke vendosur lidhur me kërkesën e Prokurorisë Themelore në Prishtinë, për dhënien e urdhrin ndëshkimor, më datë 18.05.2018, jashtë seancës gjyqësore, mori këtë:

A K T G J Y K I M

PRANOHET kërkesa e Prokurorisë Themelore në Prishtinë-Departamenti i Përgjithshëm, PP.II.nr.551/17, e datës 07.06.2017 dhe kjo gjykatë jep këtë:

URDHËR NDËSHKIMORË

I pandehuri: R.K., nga i ati H., i lindur me ..., me vendbanim në rrugën “Xh.Ll.”, në F.K., me numër personal ..., shqiptarë, shtetas i Republikës së Kosovës,

ËSHTË FAJTORË

Sepse: me datë 11.01.2017, rreth orës 12:30, në rrugën magjistrale Fushë Kosovë-Prishtinë, përkatësisht afër lokalit “D.”, i pandehuri nga pakujdesia ka vepruar në kundërshtim me nenin 120.1 të LSKRR-së, duke rrezikuar kështu jetën e njerëzve, dhe pasurinën e komunikacionit rrugor, pasi nuk mbanë distancën e nevojshme të sigurisë, meqenëse me pjesën e përparme të automjetit, të tipit “Dacia Dekkor-Furgon”, ngjyrë të bardhë, me targa ..., e godet në pjesën e pasme të automjetit të tipit “Opel Vectra”, ngjyrë të zezë, me targa ..., të cilën e drejtonte tani i dëmtuari E.M., i cili ka pësuar lëndime të lehta trupore me pasoja të përkohshme për shëndetin, si dhe janë shkaktuar dëme materiale,

- me këtë ka kryer veprën penale Rrezikimi i trafikut publik nga neni 378 par.6, lidhur me nenin 1, të KPRK.

Andaj gjykata në bazë të neneve 41, 43, 46, të KPRK-së, si dhe neneve 365 e 495, të KPPRK-së, të pandehurit i shqipton:

DËNIM ME GJOBË

Në shumë prej **200 (dyqind euro) €**, të cilin dënim, është i obliguar që ta paguaj në afat prej 15 ditëve, nga dita e plotfuqishmërisë së këtij aktgjykimi.

I dënuari dënimin e shqiptuar me gjobë mund ta paguajë me dy këste më së largu deri me datën 5 të muajit vijues. Mundësia e pagesës me këste do të revokohet nëse personi i dënuar nuk e paguan këstin me kohë.

Nëse dënimi i shqiptuar në të holla nuk mund të ekzekutohet, gjykata të njëjtin do ta ekzekutoj duke i caktuar nga një ditë burgimi për 20 (njëzet) € të gjobës

I pandehuri obligohet të paguaj shpenzimet e procedurës penale dhe atë për ekspertizën e komunikacionit shumë prej **40.88 €** dhe ekspertizën mjeko-ligjore në shumë prej **20 €**, ndërsa në emër të paushallit gjyqësorë do të paguaj shumë prej **20 €**, në afat prej 15 ditësh nga dita e plotfuqishmërisë së këtij aktgjykimi.

Të dëmtuarit: E.M, me vendbanim në fshatin U., rruga “N.V.”, Komuna F.K., si dhe të dëmtuarit (pasagjeret e tij) G.L. dhe I.F., për realizimin e kërkesës pasurore-juridike udhëzohen në kontest civil.

A r s y e t i m i

Prokuroria Themelore në Prishtinë-Departamenti i përgjithshëm, me Aktakuzën PP.II.nr.551/17, të datës 07.06.2017, e ka akuzuar **R.K.**, për shkak të veprës penale Rrezikimi i trafikut publik nga neni 378 par.6 lidhur me par. 1 të KPRK-së, dhe njëherësh, nga gjykata ka kërkuar dhënien e urdhrin ndëshkimorë, me arsyetimin së ka prova të besueshme nga kallëzimi penal, lidhur me arsyeshmërinë e akuzës së propozuar në drejtim të vërtetimit të fakteve, se i pandehuri vërtetë e ka kryer veprën penale, për të cilën akuzohet.

Gjyqtarja e vetme gjyqësore, me rastin e shqyrtimit paraprak të çështjes, konform nenit 493, të KPPRK-së, gjeti se janë plotësuar kushtet nga neni 495, të KPPRK-së, dhe pranoi kërkesën për dhënien e urdhrin ndëshkimorë si në dispozitiv të këtij aktgjykimi.

Kjo gjykatë konsideron se provat e bashkangjitura në shkresat e lëndës, dhe atë: kallëzimi penal nr.2017-AR-082, i datës 15.01.2017, mendimi dhe konstatimi i ekspertit të komunikacionit rrugorë, inxh. F.B., të datës 02.04.2017, ekspertiza mjeko-ligjore e ekspertit Dr. F.D., e datës 23.04.2017, dhe foto dokumentacioni me shkresat e tjera të lëndës janë prova të besueshme mbi bazën e të cilës vërtetohet se i pandehuri ka kryer veprën penale për të cilën është akuzuar.

Duke u bazuar në këto që u cekën më lartë, gjykata konstaton se i pandehuri **R.K.**, është penalisht përgjegjës për kryerjen e veprës penale Rrezikimi i trafikut publik nga neni 378 par.6 lidhur me par.1 të KPRK, ngase veprimet e të njëjtit i përmbajnë elementet e kësaj vepre penale.

Vendimi për kompensimin e shpenzimeve të paushallit gjyqësor, është marr në bazë të nenit 450 par.2 pika 2.6 të KPPRK-së.

Në bazë të nenit 463, par. 1 dhe 2, të KPPRK-së, pala e dëmtuar është udhëzuar në kontest civil për realizimin e kërkesës pasurore-juridike.

Nga sa u tha më lart, e në bazë të neneve 365 e 495, të KPPRK-së, u vendos si në dispozitiv të këtij aktgjykimi.

GJYKATA THEMELORE NË PRISHTINË-DEPARTAMENTI I PËRGJITHSHËM

P.nr.2869/17

Më datë 18.05.2018

Zyrtarja Ligjore
Edona Grajçevci

Gjyqtarja,

Fatime Dërmaku

KËSHILLË JURIDIKE:

Kundër këtij aktgjykimi, i pandehuri apo mbrojtësi i tij mund të paraqesin kundërshtim në afatin prej 8 ditësh, nga dita e pranimit të tij, në këtë gjykatë.